

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
FAZA E POLITIKËS/E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Konsultim
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Strategjia e zhvillimit të biznesit dhe investimeve 2014-2020 Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017 – 2022
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	26.10.2020
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	24.11.2021
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	25.11.2020
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	[2020 –MFE- nr. 28]
TE DHËNA KONTAKTI	Eldi Condi – Drejtor Kabineti, MiSHMS Eldi.condi@sipermarrja.gov.al
PJESA 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT	
<p><i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?</i></p> <p>Problemi lidhet me nevojën për rregullim me dispozita ligjore dhe kuadër ligjor mbështetës i cili përmban mekanizma nxitës për zhvillimin e startup-eve dhe mbështetjen e ekosistemit të startup-eve në Shqipëri. Panorama globale e tregjeve, ka treguar vitet e fundit një rritje të shoqërive sipërmarrëse të cilat sjellin modele, produkte apo shërbime të reja të biznesit, të cilat kanë potencial rritje në shkallë botërore, duke sjellë në kohë të shkurtër, rritje ekonomike dhe punësim. Aktualisht, disa prej të ashtuquajturave Startup-e, janë shndërruar në shoqëritë tregtare nga më të mëdhatë në botë dhe shumë prej tyre kanë sjellë modele të reja komunikimi, tregtie dhe biznesi.</p> <p>Aktualisht, në Republikën e Shqipërisë nuk ka mekanizma nxitës apo kuadër ligjor i cili rregullon specifikisht këto lloje biznesesh. Sektori i sipërmarrjeve të reja “startup” dhe programeve mbështetëse të tyre ka patur probleme të rëndësishme në lidhje me hyrjen në treg dhe përthithjen e investimeve të huaja, pavarësisht interesit në rritje kryesisht nga rinia shqiptare.</p>	

Përgjatë diskutimeve të kryera në fazën e konsultimit paraprak, problematikat kryesore të identifikuar mund të përmblihen si më poshtë:

- 1) Mungesa e një përkufizimi ligjor mbi terminologjinë se çfarë konsiderohet një sipërmarrje e re në faze ideje ose produkti minimal të përdorshëm pra një “startup”;
- 2) Vështirësi në lidhje me aksesin në financim, mungesa e mbështetjes ligjore për të marrë hua nga institucionet bankare, mungesa e garancive të rreziqeve të lidhura me kreditimin nga qeveria. Mungese legjislativi për të nxitur hyrjen në treg të investitorëve të kapitalit, kapitalit të riskut apo të engjëjve të biznesit.
- 3) Mungesa e informacionit mbi aspektet fiskale dhe ligjore që lidhen me krijimin e sipërmarrjeve të reja, sidomos nga të rinjtë.
- 4) Mungesa e një kuadri ligjor që rregullon, nxit dhe përthith investimet e huaja dhe aktorët mbështetës në fushën e krijimit të sipërmarrjeve të reja që sjellin risi dhe stimulojnë ekonominë.
- 5) Tregu lokal konsiderohet relativisht i vogël dhe ka vështirësi në hyrjen në tregun rajonal apo global.

Si pasojë e mungesës së legjislativit, duke konsideruar tendencat gjithmonë e më shumë në rritje drejt startup-eve dhe ekosistemeve të tilla në rajon dhe jo vetëm, lind nevoja e miratimit të një ligji të ri që adreson problematikat e sipër përmendura.

OBJEKTIVAT

Cilët janë objektivat dhe efektet e synuar të propozimit?

- *Krijimi i një regjistri për të gjithë të dhënat për Start Up-et, sipas parashikimeve të kësaj politike, brenda vitit 2022.*
- *Shpërndarja e të pakten 80% të shumës së dedikuar për Start Up-et brenda 4 viteve të ardhshme.*
- *Rritja e numrit të Start Up-eve të regjistruara me ‘80% brenda vitit 2025.*
- *Garantimi i mbijetesës së të pakten 50% të Start Up-eve të reja, që perfitojnë nga kjo politike, pas fazes së inkubimit.*
- *Rritja me 40% e kapitalit të huaj për mbështetjen Start Up-et brenda vitit 2025.*

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/të përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsioni 0 - Ruajtja e status quo-së pa ndërhyrje në kuadrin ligjor ekzistues Ligji nr. 8957, date 17.10.2002, “Për ndermarrjet e vogla dhe të mesme”.

Ky opsion nënkupton mosndërmarrjen e asnjë politike, duke vijuar me funksionimin sipas legjislativit aktual, pa dispozita konkrete dhe specifike për Startup-et. Ky opsion nuk ofron kosto shtesë por nga ana tjetër nuk ofron asnjë avantazh krahasuar me gjendjen ekzistuese dhe pamundëson dhe vonon reagimin e qeverisë ndaj kërkesave të tendencave të tregut që lidhen me inovacionin.

Opsioni 1 - Ndryshimi i ligjit nr. 8957, date 17.10.2002, “Për ndermarrjet e vogla dhe te mesme”.

Ky opsion mund të ndërmerret duke i përfshirë dispozitat e reja për Startup-et brenda kuadrit më të gjerë të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që rregullohen nga Ligji nr. 8957, date 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla dhe te mesme”. Ky opsion është më i favorshëm se opsioni 0, por duke qenë se opsioni 2 ofron një kuadër specifik, i cili ofron mbështetje specifike jo vetëm për bizneset e reja, si NVM, por edhe si nxitje e komponentit të inovacionit, është zgjedhur si më i preferuari. Kjo edhe për faktin se kjo kategori e veçantë e sipërmarrjes ka nevoja specifike, të veçanta dhe përtej atyre që lidhen me NVM tradicionale. Startup-et që kalojnë me sukses fazën fillestare, rriten me shpejtësi duke i tejkaluar dimensionet e NVM dhe duke u shndërruar në shoqëri të mëdha.

Opsioni 2 - Hartimi i një projektligji të posaçëm për Startup

Ky opsion krijon mundësinë e krijimit të një kuadri ligjor unik dhe të veçantë për startup-et, duke e lehtësuar barrën rregullatore dhe fiskale në ngarkim të tyre, duke krijuar një organ mbështetës të posaçëm si edhe duke unifikuar procedurat e zbatueshme për vetëdeklarimin online në regjistrin elektronik dhe mbështetjen e tyre nëpërmjet shërbimit “one-stop-shop”. Ky opsion ofron një përgjigje të ligjvënësit me fokus të veçantë, i cili i jep përgjigje nevojave dhe karakteristikave të kësaj kategorie biznesi.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar lidhen me faktin se pas miratimit të këtij ligji, startup-et, do të kenë një kuadër ligjor dhe institucional i cili i përgjigjet nevojave të tyre. Në veçanti organet si Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Këshilli i Startup-eve, do të adresojnë problematikat e tyre dhe do të lehtësojnë komunikimin midis aktorëve të tregut dhe përthithjen e subjekteve të cilët i mungojnë tregut aktual.

Mekanizmat nxitës do të sjellin krijimin, themelimin dhe regjistrimin në një databazë elektronike të të gjitha startup-eve në vend nëpërmjet vetëdeklarimit elektronik të tyre dhe lehtësuesve dhe më pas në procesin afatgjatë regjistrimin e subjekteve tregtare të reja dhe rritjen e përmasave të tyre në kohë të shpejtë, duke krijuar zhvillim ekonomik dhe rritje të punësimit.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni 2 - Hartimi i një projektligji të posaçëm për Startup preferohet pasi i ofron një paketë ligjore unike një kategorie biznesesh të cilat për nga dimensionet dhe karakteristikat kanë nevojë për një paketë ligjore të veçantë. Në këtë mënyrë, nëpërmjet këtij ligji, përmbledhen gjithë masat mbështetëse, krijohet një organ i posaçëm, si edhe përcakton procedurat elektronike për vetëdeklarimin e tyre duke sjellë krijimin e një regjistri elektronik, që i bën ato të pranueshëm për aplikimin dhe përfitimin nga masat mbështetëse. Trajtimi sipas këtij

ligji, identifikon bizneset e reja, i ndihmon të formalizohen, të regjistrohen në regjistrin elektronik të vetëdeklarimit. Në këtë mënyrë i ofrohet ndihmë në fazën fillestare, startup-eve të cilat nëse zhvillohen në mënyrën e duhur, arrijnë të kenë një rritje të shpejtë dhe të sjellin një impakt domethënës në rritjen e ekonomike dhe punësimin duke sjellë edhe risi inovative të ndjeshme në mjedisin ekzistues të biznesit.

Ky opsion supozohet të sjellë përfitime ekonomike dhe sociale afatgjata nga ato startup-e të cilat do të arrijnë të kalojnë me sukses fazën paraprake të zhvillimit të ideve të reja të biznesit. Zhvillimi i tyre do të sjellë jo vetëm rritje ekonomike dhe të punësimit, por edhe modele të reja biznesi, zbatim të modeleve të ndryshme si edhe rritje të aksesit të shoqërive shqiptare në tregjet globale. Nga ana tjetër, tërheqja e investitorëve të kapitalit, do të shtojë financimet në kapitalin e shoqërive vendase dhe rritjen e shpejtë të përmasave të tyre.

Njëkohësisht, mbështetja e tyre në fazën e inkubimit 24 mujore, do të pasjellë edhe kosto ekonomike, të cilat lidhen kryesisht me grantet financiare të akorduara sipas këtij akti

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3 -vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lekë, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
302.119.849	302.119.849	302.119.849

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?

Konsultimi është kryer me përfaqësues të komunitetit dhe aktorët ekzistues, të tillë si mbështetës të startup-eve ekzistues, si edhe me konsulentët ndërkombëtare, organet e qeverisjes vendore ne bazë të ligjit Nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen Vendore”, që zbatojnë programe mbështetës si edhe me organet e përfshira në mbështetjen e sipërmarrjes dhe inovacionit. Të tilla janë Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit. Gjatë periudhës së konsultimit ka pasur komente të shumta nga startup-et, si edhe nga organizatat suportuese së startup-eve në vend, pjesa më e madhe e e të cilave janë marrë në konsideratë për hartimin e projektligjit. Si psh Triple city, Destil Creative Hub, ICT Media etc, të cilët kanë pasur këto pyetje specifike të pasqyruara më poshtë:

Cilat janë kriteret qe nje lehtesues ” të certifikohet” si nje i tille?

Si do te perzgjidhen anetaret e bordit?

Ornold Bazaj : Sektorët ekonomik te përfshira do të jenë të kufizuara pasi po flasim vetëm për teknologjine ,a do të perfshi ky projektligj në brendësi të tij edhe mbeshtetjen për sektor të tjerë të ekonomisë si turizmi prsh .

Ky ligj mbeshtet start up-et, te cilat mund te aplikohen ne cdo sektor te ekonomise. Pra ky ligj nuk kufizon sektoret ekonomike ku zbatohet vetëm inovacioni. Nese nje projekt ide, zbatohet ne turizem ose dhe në cdo fushë tjetër, atehere ajo eshte e kualifikueshme per te

perfituar masat mbeshtetese sipas ketij ligji.

Anila Smorgrav : Çfare parashikon ligji mbi kohezgjatjen e te qenurit startup?

Ky ligj ofron masa mbeshtetese per periudhen fillestare te biznesit, e cilesuar si periudhe inkubimit, me kohezgjatje 24 mujore, pervec rasteve te vecanta, kur kjo periudhe mbeshtetejeje mund te zgjatet me tej.

Konsultimi është fokusuar tek identifikimi i nevojave të startup-eve, modelet e zbatueshme si edhe vlerësimi mbi opsionet e ndërhyrjes në legjislacion.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Zbatimi dhe monitorimi i këtij ligji, është detyrë e ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes , i cili do të lidhë marrëveshjet me subjektet përfitues dhe do të verifikojë zbatimin korrekt nga ana e tyre të dispozitave ligjore.

Kjo fazë fokusohet tek verifikimi i përputhshmërisë së zbatimit të kriterëve sipas ligjit dhe kushteve të marrëveshjeve të zbatimit të lidhur midis ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe aplikuesve fitues, për përfitimin e masave mbështetëse.

Në baze dhe zbatim te ketij ligji, dalin akte nenligjore, vendime te Keshillit te Ministrave që rregullojnë fusha te brendshme te tij, si Këshilli i Startup-eve, rregullat e aplikimeve, dokumentacionin dhe metodologjinë e shqyrtimit, certifikimin dhe monitorimin

PJESA 2. BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Jepni kontekstin e politikës

Aktualisht legjislacioni ekzistues mbi Ligjin nr. 8957, date 17.10.2002, “Për ndermarrjet e vogla dhe te mesme” rregullon edhe disa çështje të cilat lidhen indirekt me Startup-et, si edhe ekzistojnë disa nisma të cilat prekin edhe Startup-et, të tilla si fondet e zbatuara nga AIDA. Por fokusi i tyre është më i gjerë pasi këto fonde aktualisht i jepen çdo sipërmarrjeje të re. Për pasojë ky kuadër ekzistues nuk është i adresuar specifikisht tek startup-et, por brenda kuadrit të gjerë të NVM. Përpos kësaj, Startup-et që kalojnë me sukses fazën fillestare të inkubimit të biznesit, rriten me shpejtësi duke i tejkaluar dimensionet e NVM dhe duke u shndërruar në shoqëri të mëdha, të cilat kanë qarkullim financiar në vlera të larta dhe nivel domethënës punësimi.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria/biznesi /shoqëria civile /qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave*

Pavarësisht se ligji nr. 8957, date 17.10.2002, “Për ndermarrjet e vogla dhe te mesme” ka disa dispozita dhe masa të cilat lidhen indirekt me Startup-et, nuk ka aktualisht një bazë të dhënash,

një organ dhe një politikë unike, e cila ndihmon dhe nxit krijimin dhe vetëdeklarimin online të startup-eve.

Kjo lidhet edhe me faktin që tendencat globale kanë sjellë që bizneset e reja të fokusohen tej mase drejt risive dhe ideve alternative të ngritjes së një biznesi, në ndryshim me mënyrat tradicionale dhe klasike të biznesit. Mungesa e dispoziatave ligjore dhe mospasja e një pakete mbështetëse për këto startup-e, shihet si një pengesë dhe pamundësi për realizimin e potencialit të startup-eve edhe në Shqipëri, duke tërhequr edhe subjektet ndihmues të mjedit të biznesit, të dobishëm për inkubimin dhe financimin e tyre.

Spektori i start-up ka pasur probleme te rendsishme ne lidhje me perthithjen e investimeve te huaja, pavarisht interesit nga rinia shqiptare, dhe keto probleme reflektohen ne aksesin dhe mbështetjen financiare te tyre.

Pas bisedave te zhvilluara gjate konsultimit paraprak, problematikat e identifikuar mund te permbliidhen si me poshte:

1. Mungesa e nje perkufizimi te aplikueshem per cfare eshte nje start-up;
2. Aksesin ne finance, mungesa e mbështetjes ligjore per te marrë hua nga banka, mungesa e garancive nga qeveria. Mungese legjislacioni per te incentivuar prezencen e angel investors dhe te venture capital.
3. Iniciativa fiskale- mungesa e lehtesirave fiskale per periudhen e inkubimit te start-upeve.
4. Informacioni- mungesa e informacionit per aspektet fiskale dhe ligjore nga ana e start-upeve.
5. Legjislacioni – mungesa e nje baze legjislativie qe rregullon, incentivon dhe perthith investime te huaja ne fushen e start-upeve.
6. Aksesin ne treg- tregu lokal konsiderohet relativisht i vogel, dhe ka veshtiresi ne aksesimin e tregut rajonal apo global.

Grupet e prekura jane kryesisht te rinj, me kapacitete ne te gjitha fushat: agrokulturë, distribucion, fushën e teknogjive, inovacionit, të cilët kanë ide biznesi dhe duhen ndihmuar në realizimin e tyre ose biznese të reja të sapo themeluara.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë*

Momentalisht, situata në ekosistemin e start-upeve në Shqipëri nuk është e rregulluar, për pasojë lind nevoja e një ligji të ri që adreson të gjitha problematikat e përmendura me sipër.

Për zgjidhjen e problematikave të hasura prej tyre, u kërkua nga komuniteti dhe aktorët, hartimi i një pakete ligjore e cila trajton mbështetjen dhe rregullat që i zbatohen kësaj kategorie.

Nevoja kryesore lidhet me reagimin në kohë të qeverisë ndaj tendencave të tregut, i cili po shkon pashmangshmërisht drejt zbatimit të modeleve të ndryshme të biznesit.

Ndërhyrja synon të krijojë një mjedis të përshtatshëm për këto lloj shoqërisht, duke krijuar kuadrin ligjor dhe institucional si edhe duke detajuar mekanizmat e mbështetjes shtetërore.

Nga ana tjetër kjo nismë favorizon formalizimin e bizneseve ekzistuese, krijimin e sipërmarrjeve të reja dhe adresimin e modeleve të biznesit tek inovacioni.

Për këto arsye, është e nevojshme ndërhyrja në kuadrin ligjor ekzistues, nëpërmjet miratimit të një pakete ligjore të posaçme, e cila zbaton objektivat e strategjive kombëtare të miratuara.

Duke konsideruar objektivat e strategjive të miratuara, projektligji zbaton gjetjet e Strategjisë së zhvillimit të biznesit dhe investimeve 2014-2020 e cila përcakton se ende mungojnë politikat mbështetëse për bizneset start-up dhe mungojnë burimet financiare alternative si kapitali i rrezikuar - venture capital, skema vouchere për inovacionin - innovation vouchers, engjëj biznesi - business angels, etj (ref 3.1.6. Sfidat për zhvillimin e SME-ve). Projektligji zbaton disa nga qëllimet specifike të strategjisë (Ref 2.iii - Zhvillimi i biznesit inovativ dhe 2.iv - Zhvillimi i SME-ve dhe sipërmarrjes), sipas të cilave synohet rritja e aplikimit të teknologjive të reja, rritja çdo vit e numrit të ndërmarrjeve të reja dhe atyre inovative dhe futjen e instrumenteve të reja financiare, në veçanti në mbështetjen e atyre bizneseve që janë në fazën fillestare të tyre (start-up).

Gjithashtu projektligji implementon objektivat dhe prioritetet e Strategjisë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017 – 2022 e cila përcakton si objektiv të sajin nxitjen e biznesit për krijimin e Sipërmarrjeve të Reja (Start-Up) në Inovacion dhe teknologji (Qëllimi 1, Objektiv 3).

Bazuar mbi praktikën mira ndërkombëtare, si dhe duke konsideruar impaktin domethënës që kanë sjellë vitet e fundit startup-et në ekonominë globale, duke u renditur në vendet e para të klasifikimit të bizneseve, nevojitet miratimi i një kuadri ligjor të posaçëm, i cili rregullon dhe krijon masat mbështetëse që i jepen kësaj kategorie.

Përfundimi mbi nevojën e krijimit të një kuadri ligjor të posaçëm ka ardhur si pasojë e analizës së nevojave dhe nga opinionet dhe kërkesat e marra nga vetë komuniteti i organizatave që ofrojnë mbështetje për startup-et. Puna ekzistuese, përtej konsultimit me ta, ka përfshirë edhe analizën e modeleve dhe praktikave më të mira si edhe opinionet e ekspertëve ndërkombëtarë dhe vendas.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

- Krijimi i nje regjistri per te gjithë te dhenat per Start Up-et, sipas parashikimeve te kesaj politike, brenda vitit 2022.
- Shperndarja e te pakten '80'% te shumes se dedikuar per Start Up-et brenda 4 viteve te ardhshme.
- Rritja e numrit te Start Up-eve te regjistruara me '80'% brenda vitit 2025.
- Garantimi i mbijeteses se te pakten '50'% te Start Up-eve te reja, qe perfitojne nga kjo politike, pas fazes se inkubimit.

2

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Opsioni 0 – Ruajtja e status quo-së pa ndërhyrje në kuadrin ligjor ekzistues

Ky opsion nënkupton mosndërmarrjen e asnjë politike, duke vijuar me funksionimin sipas legjislacionit aktual, pa dispozitat konkrete dhe specifike për Startup-et. Ky opsion nuk ofron asnjë avantazh krahasuar me gjendejen ekzistuese

Opsioni 1 - Ndryshimi i ligjit për NVM

Ky opsion mund të ndërmerret duke i përfshirë dispozitat e reja për Startup-et brenda kuadrit më të gjerë të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që rregullohen nga Ligji nr. 8957, date 17.10.2002, "Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme". Ky opsion është më i favorshëm se opsioni 0, por duke qenë se opsioni 2 ofron një kuadër specifik, i cili ofron mbështetje specifike jo vetëm për bizneset e reja, si NVM, por edhe si nxitje e komponentit të inovacionit, është preferuar si më i miri.

Opsioni 2 – Hartimi i një projektligji të posaçëm për Startup

Ky opsion krijon mundësinë e krijimit të një kuadri ligjor unik dhe të veçantë për startup-et, duke e lehtësuar barrën rregullatore dhe fiskale në ngarkim të tyre, duke krijuar një organ mbështetës të posaçëm si edhe duke unifikuar procedurat e zbatueshme për certifikimin dhe mbështetjen e tyre

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*

- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe rreziqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Projektligji prek kryesisht ideatorët dhe nismëtarët e një sipërmarrjeje, pra startupet, si dhe subjektet mbështetës, të përkufizuar si lehtësues, kryesisht inkubatorë dhe financues të startup-eve.

Ndikimet e drejtpërdrejta për këto subjekte lidhen me ndikimet pozitive që kanë masat mbështetëse që ofron kuadri ligjor dhe në mënyrë indirekte, këto subjekte dhe mjedisi i biznesit do të përfitojnë nga ngritja e eko sistemit të favorshëm, hyrja e aktorëve të rinj mbështetës dhe efektet pozitive në treg që derivojnë nga modelet e zbatuara në praktikë, zbatimi i modeleve të reja të biznesit, zhvillimi ekonomik, rritja eksponenciale dhe punësimi.

Ndikim pozitiv është mbështetja financiare që do jepet në formën e granteve në shumën totale për 10 milion euro në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Kuadri i ri ligjor do të ketë efekte pozitive, direkte dhe të menjëhershme për sipërmarrje të reja që do të vetëdeklarohen në regjistrin elektronik dhe mbështeten si startup-e.

Përtej tyre, projektligji sjell përfitime edhe për bizneset ekzistuese, duke i lehtësuar ato që të adresohen drejt inovacionit, teknologjisë dhe modeleve të reja të biznesit. Disa nga faktorët që mund të ndikojnë në mosrealizimin e objektivave të vendosura janë si më poshtë vijon:

mungesa e informacionit, nga grupet e interesit, mbi ekzistencën e mekanizmave të ndihmës; mosmiratimi në kohë i akteve nënligjore të ligjit; pengesat lidhur me mënyrën e zbatimit të kuadrit rregullator.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni 2 i lidhur me hartimin e një projektligji të posaçëm për Startup, mundëson krijimin e një kuadri ligjor unik dhe të veçantë për startup-et, duke e lehtësuar barrën rregullatore dhe fiskale në ngarkim të tyre, duke krijuar një organ mbështetës të posaçëm si edhe duke unifikuar procedurat e zbatueshme për certifikimin dhe mbështetjen e tyre. Ky opsion preferohet pasi ofron një paketë ligjore unike, përmbledhjen e të gjitha masave mbështetëse, krijon një organ të posaçëm, si edhe përcakton procedurat e zbatueshme për vetëdeklarimin në regjistrin elektronik dhe përfitimin nga masat mbështetëse. Trajtimi sipas këtij ligji, identifikon startup-et, i ndihmon të vetëdeklarohen në regjistrin elektronik të startup-eve dhe të vetëregjistrohen elektronikisht duke mbledhur informacion për databazën e startup-eve dhe lehtësuesve në Shqipëri. Në këtë mënyrë i ofrohet ndihmë në fazën fillestare, startup-eve të cilat nëse

zhvillohen në mënyrën e duhur, arrijnë të kenë një rritje të shpejtë dhe të sjellin një impakt domethënës në rritjen e ekonomike dhe punësimin duke sjellë edhe risi inovative të ndjeshme në mjedisin ekzistues të biznesit.

Ky opsion supozohet të sjellë përfitime ekonomike dhe sociale nga ato startup-e të cilat do të arrijnë të kalojnë me sukses fazën paraprake të zhvillimit të ideve të reja të biznesit

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Kjo fazë fokusohet tek verifikimi i përputhshmërisë së zbatimit të kriterëve sipas ligjit dhe kushteve të marrëveshjeve të zbatimit të lidhur midis ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe aplikuesve fitues, për përfitimin e masave mbështetëse.

Disa nga faktorët që mund të ndikojnë në mosrealizimin e objektivave të vendosura janë si më poshtë vijon:

mungesa e informacionit, nga grupet e interesit, mbi ekzistencën e mekanizmave të ndihmës; mosmiratimi në kohë i akteve nënligjore të ligjit;

pengesat lidhur me mënyrën e zbatimit të kuadrit rregullator

Masat për zbatimin e qëllimeve lidhen me:

konsultimin e vazhdueshëm të bizneseve;

krijimin e regjistrit elektronik të vetëdeklarimit të startup-eve;

lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit nga ministri i Shtetit për Mbrojtjen e

Sipërmarrjes, duke forcuar mekanizmat e bashkëpunimit në veçanti midis organeve publike, sipërmarrjes dhe institucioneve të arsimit të lartë.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Vlerësimi i përputhshmërisë në fazën e zbatimit dhe monitorimi do të kryhet nga ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes . Disa nga indikatorët që do të shërbejnë në vlerësimin e suksesit të zbatimit të politikës dhe të realizimit të objektivave lidhen me:

- numri i aplikimeve për fonde;
- numrin e startup-eve të krijuara gjatë periudhës që pason miratimin e projektligjit;
- numrin e bizneseve që do të mbijetojnë mbas fazës së inkubimit;
- shumën e granteve të dhëna cdo vit në krahasim me periudhën para hyrjes në fuqi të ligjit;
- përqindjen e shfrytëzimit të shumës së granteve të dedikuara për startup-et;
- numrin e personave të punësuar në startup-e në krahasim me periudhën para hyrjes në fuqi të ligjit , bazuar në kriteret ligjore si edhe në kushtet e detajuara në marrëveshjen e zbatimit.

Tabela. Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

Në këtë RIA, kemi llogaritur si kosto për buxhetin, duke supozuar shumën që do të alokohet nga buxheti i shtetit në formën e granteve dhe shërbime mbështetëse (trajnim, këshillim) në shumën 1.208.479.396 Lekë (10 milionë Euro). Pra kuantifikimi i përfitimeve është parashikuar për startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve nëpërmjet skemës së mbështetjes me grante nga buxheti i shtetit në masën 1.208.479.396 Lekë (10 milionë Euro) të disbursueshme përgjatë 4 vjecarit të ardhshëm, duke i kuantifikuar përfitimet për startupet.

Në vitin e parë janë parashikuar kosto gjithsej **302.119.849** lekë, e cila përfshin grante në formën e mbështetjeve financiare direkte për startup-et që plotësojnë kriteret, si edhe pagesën për anëtarët e komisionit të përbërë nga 5 anëtarë ad-hoc, që do të mbledhet mesatarisht 3 herë në vit për përzgjedhjen e ideve fituese, si edhe hartimin e raporteve vjetore për parashikimin e nevojave për aftësim nga startup-et dhe lehtësuesit.

Në vitin e dytë po ashtu janë parashikuar kosto gjithsej **302.119.849** lekë, e cila përfshin grante në formën e mbështetjeve financiare direkte për startup-et që plotësojnë kriteret, si edhe pagesën për anëtarët e komisionit të përbërë nga 5 anëtarë ad-hoc, që do të mbledhet mesatarisht 3 herë në vit për përzgjedhjen e ideve fituese, si edhe hartimin e raporteve vjetore për parashikimin e nevojave për aftësim nga startup-et dhe lehtësuesit.

Në vitin e tretë deri në vitin e katërt janë parashikuar kosto të përvitshme **302.119.849** lekë, të cilat përfshijnë grante në formën e mbështetjeve financiare direkte për startup-et që plotësojnë kriteret, si edhe pagesën për anëtarët e komisionit të përbërë nga 5 anëtarë ad-hoc, që do të mbledhet mesatarisht 3 herë në vit për përzgjedhjen e ideve fituese, si edhe hartimin e raporteve vjetore për parashikimin e nevojave për aftësim nga startup-et dhe lehtësuesit.

Parimi i “**Value for money**” është përdorur për llogaritjen e efikasitetit dhe efektivitetit maksimale për çdo lekë të planifikuar dhe shpenzuar nga buxheti i shtetit. (me shkallën e përfitimit nga biznesi që pritet të jete maksimale në 100 %).

Përfitimet në shërbime mbështetëse për biznesin nëpërmjet dijeve, njohurive, aftësive, do të përthihen prej tyre, të cilat në mënyrë direkte reflektohen në krijimin e një klime të favorshme të bërit biznes, nxitjes së vetëpunësimit dhe punësimit të rinjve, shqiptarë dhe të huaj, dhe një shkallë të rritur të treguesve ekonomik-financiarë të biznesit në të ardhmen. Vlera prezente aktuale e kostos në total është 1.208.479.396 Lekë (10 milionë Euro), ndërsa vlera prezente aktuale e përfitimit në total është te pakten 1.208.479.396 Lekë, duke llogaritur Vlerën Prezente Neto Aktuale (VAN) në shumën prej 0 lekë.

Më poshtë gjeni përlogaritjen e vlerës aktuale neto të opsionit të preferuar.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4
Faktori zbritës	1	0.95	0.90	0.86
Kostoja për buxhetin – një herë				
Kostoja për buxhetin – në vazhdim	302.119.849	302.119.849	302.119.849	302.119.849
Kostoja për biznesin – një herë				
Kostoja për biznesin – në vazhdim				
Kostoja për grupet e tjera – një herë				
Kostoja për grupet e tjera – në vazhdim				
Kostoja në total	302.119.849	302.119.849	302.119.849	302.119.849
Kostoja e zbritur në total = Kostoja në total x faktorin zbritës	302.119.849	287.013.857	271.907.864	259.823.070
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim				
Përfitimi për biznesin – një herë				
Përfitimi për biznesin – në vazhdim	302.119.849	302.119.849	302.119.849	302.119.849
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë				
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim				
Kostoja për buxhetin – në vazhdim				
Përfitimi në total	302.119.849	302.119.849	302.119.849	302.119.849
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës	302.119.849	287.013.857	271.907.864	259.823.070
Vlera aktuale e kostos në total	1.208.479.396			
Vlera aktuale e përfitimit në total	1.208.479.396			

Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	0			
--	---	--	--	--

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	nuk eshte llogaritur	nuk eshte llogaritur	nuk eshte llogaritur
Opsioni 2	1208,480	1208,480	0